

# Njoftim Publik

Në Drejtorin e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës është dorëzuar kërkesa për caktimin e kushteve ndërtimor 05nr.350/03 - 304461/19 dt.16.12.2019, në emër të kërkuarit / pronarit dhe Investitorit "Partner & Dervisholli"sh.p.k. nga Prishtina, për parcelën kadastrale nr.823-14 ZK Matičan, në kuadër të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë.

Me kërkesën e lartë cekur është prezantuar edhe projekt propozimi i kompleksit të lartcekur.

Bazuar në paragrafin 2 të nenit 18 të Ligjit për Ndërtim nr.04/L-110 dt.31.05.2012, para caktimit të kushteve ndërtimore "Organi kompetent njofton publikun dhe mundëson komentet për kërkesën e dhënies së kushteve ndërtimore dhe lejen ndërtimor".

Komentet lidhur me këtë projekt propozim të dorëzohen nga data: **20.12.2019** gjerë **03.01.2020**, në Email-in adresën: [urbanizmi@prishtine.gov.net](mailto:urbanizmi@prishtine.gov.net)

<b>Kushtet e propozuara për ndërtimin e Kompleksi "Residio VI" me ndërtesë shumë banesore &amp; afariste me etazhitet 2B+S+P+7+Ph, në kuadër të Bllokut urban "C10", Tërësia "C", të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë</b>	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	"Arë e klasit 3" "Tokë ndërtimore"
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues = 0m`
c. Vija ndërtimore	Sipas planit rregullues = 5.50m`
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	Në vijë ndërtimore
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale	25m'/4.5m' & 25m'/3.0m'
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHP=40 %
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHGJ=40 %
h. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISPN=2.2 & 3.0,
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHPN = 60 %
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	35 VP brenda ndërtesës 11 VP jashtë ndërtesave
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	PO
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	PO
m. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/>	
n. shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë me të madhe se sa zona për rreth? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të UA 06/2017, dt.23.05.2017 të MMPH-së, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës. Në të gjitha komentet tuaja duhet të përshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë.

Nënshkrimi i Zyrtarit: \_\_\_\_\_

